



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1689/5 prot.

Datë 17.07.2025

V E N D I M
Nr. 920/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “DEJA” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51807-06-19-2025 me objekt “*Hartim i planeve per Mbareshtim Pyjor*”, me fond limit 7,269,370.00 lekë pa TVSH, parashikuar per tu zhvilluar në datën 04-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenice.

Autoriteti Kontraktor: “Bashkia Selenice” me adresë:
Selenice Vlore ,1001

Ankimues: DEJA” SHPK, me nipt K37509969C dhe adresë:
Rruga Strasburgu Nr 21, Kamez, Tirane, Zona kadastrale 2066, Nr. pasurise 129/765.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 25.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.06.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-51807-06-19-2025, me objekt “Hartim i planeve për Mbareshtim Pyjor”, me fond limit 7,269,370.00 lekë pa TVSH, lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenice.

II.2. Në datën 26.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5484 dhe me nr. 1689/2025 protokoli, datë 27.06.2025, e operatorit ekonomik “DEJA” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në piken 2 të nenit 112, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë.

II.4. Me anë të shkresës nr. 1689/1 prot., datë 16.07.2025, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Deja” SHPK.”, Komisionit i Prokurimit Publik iu drejtuar autoriteti kontraktor për dorëzimin e informacionit mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik.

II.5. Me anë të shkresës nr. 1709/1 prot., datë 14.07.2025, me objekt “Dërgim i vendimit”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.1689/2 prot., datë 17.07.2025, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e ankesës si më poshtë vijon:

[...]

“Për sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të ankesave i përbër nga unanimitë

VENDOSËN:

Për zbatim të ligjit 162/2020 datë 23.12.2020 për "Prokurimin Publik neni 114 trajtimi i ankesës nga Autoriteti ose enti kontraktor dhe Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

Pranimin e ankesës të operatorit DEJA sh pk, me nipt K37509969C për procedurën me objekt: "Hartim i planeve për mbareshtim pyjor" me Nr. REF-51807-06-19-2025 pasi pretendimet e ngritura qëndrojnë.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet shkresës nr. 1709/1 prot., datë 14.07.2025, me objekt “*Dërgim i vendimit*”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.1689/2 prot., datë 17.07.2025, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e ankesës si më poshtë vijon:

[...]

“Për sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të ankesave i përbër nga unanimishtë

VENDOSËN:

Për zbatim të ligjit 162/2020 datë 23.12.2020 për "Prokurimin Publik neni 114 trajtimi i ankesës nga Autoriteti ose enti kontraktor dhe Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

Pranimin e ankesës të operatorit DEJA sh pk, me nipt K37509969C për procedurën me objekt: "Hartim i planeve për mbareshtim pyjor" me Nr. REF-51807-06-19-2025 pasi pretendimet e ngritura qëndrojnë.”

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “*Për prokurimin Publik*” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1.Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga

operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr. 1709/1 prot., datë 14.07.2025, me objekt “*Dërgim i vendimit*”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.1689/2 prot., datë 17.07.20245, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e ankesës, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar për tu modifikuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “DEJA” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51807-06-19-2025 me objekt “*Hartim i planeve per Mbareshtim Pyjor*”, me fond limit 7,269,370.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenice.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit sipas vendimit të KSHA-së dhe të publikojë shtojcën në SPE për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “DEJA” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

